



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.496/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Shemsi Maksuti, anëtarë i kryesisë së subjektit politik PDK, në Skenderaj, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e parashtruar nga Shemsi Maksuti, anëtarë i kryesisë të subjektit politik PDK, me shenjen ZL.A.nr.496/2017 e datë 24.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 24.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Shemsi Maksuti, në të cilën ka theksuar se nuk përputhen shifrat e rezultateve që i kanë vëzhguar me ato të formularit përfundimtarë. Më tej ka kërkuar që të numërohen gjitha kutitë, në të gjitha Qendrat e Votimit në Skenderaj.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesë sepse, pretendimet ankimore që ndërlidhen me rezultatin e votimit duhet të parashtrohen me rastin e publikimit të shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Shemsi Maksuti, nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë tjetër, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

ZL. Anr.496/2017 më datën 24.10.2017.



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*